



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/65

Datë: 18.02.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 2 paragrafi 1. të Ligjit Nr. 03/L-050 për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 shkurt 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Strategjia e Sigurisë së Republikës së Kosovës 2021-2030.
2. Strategjia nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/65

Datë: 18.02.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 2 paragrafi 3. të Ligjit Nr. 03/L-063 për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 shkurt 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Platforma Vjetore e Politikës së Inteligjencës dhe Sigurisë për vitin 2021.
2. Platforma nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet për informim Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe Drejtorit të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, për veprim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/65

Datë: 18.02.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 shkurt 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Themelohet Këshilli Organizativ për manifestimin gjithë-popullor për shënimin e Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila do të mbahet nën patronatin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës z. Avdullah Hoti më 5, 6 dhe 7 mars në këtë përbërje:
  - 1.1. Z. Anton Çuni, Ministër i Mbrojtjes, Kryesues;
  - 1.2. Z. Bekim Jashari, Kryetar i Komunës së Skenderajt, anëtar;
  - 1.3. Znj. Vlora Dumoshi, Ministre e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, anëtare;
  - 1.4. Znj. Meliza Haradinaj-Stublla, Ministre e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, anëtare dhe
  - 1.5. Agim Veliu, Ministër i Punëve të Brendshme, anëtar.
2. Ftohen t'a dërgojnë nga një përfaqësues:
  - 2.1. Zyra e Presidentit;
  - 2.2. Kuvendi i Kosovës;
  - 2.3. Komuna e Prishtinës;
  - 2.4. Organizatat e Dala nga Lufta e UÇK-së;
  - 2.5. Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe
  - 2.6. Organizatat e Shoqërisë Civile.
3. Për punën e Këshillit Organizativ për shënimin e Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ndahen mjete financiare në vlerë prej dyzetë mijë euro (40.000 €).
2. Mjetet nga pika 3. e këtij vendimi merren nga nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria e shpenzimeve Rezervat dhe transferohen në organizatën buxhetore, Ministria e Mbrojtjes.
3. Obligohet Këshilli Organizativ dhe institucionet përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HOTI**



\_\_\_\_\_  
Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/65  
Datë: 18.02.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 shkurt 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Shtetit të Kuvajtit për Statusin e Pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në Shtetin e Kuvajtit.
2. Përgjatë negociimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Mbrojtjes obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/65

Datë: 18.02.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 shkurt 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Fushën e Policisë Ushtarake.
2. Obligohen Ministria e Mbrojtjes dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/65

Datë: 18.02.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 shkurt 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Strategjia e Mbrojtjes së Republikës së Kosovës.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit, respektivisht Zyra për Planifikim Strategjik për hartimin e Planit të Veprimit për zbatimin e kësaj Strategjie.
3. Ngarkohen institucionet e sektorit të sigurisë dhe mbrojtjes të Republikës së Kosovës dhe institucionet tjera përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/65

Datë: 18.02.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 shkurt 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Strategjia Shtetërore e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit 2020-2025 dhe Plani i Veprimit 2020-2023.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe të gjitha institucionet kompetente për zbatimin e Strategjisë nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/65

Datë: 18.02.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24 të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 shkurt 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Teksti në pikën 1.2, masa 2. e vendimit të Qeverisë Nr. 06/58 të datës 14.01.2021 riformulohet në si vijon: "Për sektorin e arsimit ndahen mjetet shtesë financiare në vlerë prej 3,000,000 € (tre milionë euro) për pagesën e shtesës së parë për mësimdhënësit dhe personelin teknik/administrativ në sistemin para universitar për angazhimin e shtuar dhe të ekspozuar drejtpërdrejt ndaj pandemisë COVID-19. Shtesa e parë në pagë sipas këtij paragrafi paguhet për muajin shkurt 2021 në vlerë 100 € (njëqind euro) për person. Organizatat Buxhetore (OB): Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) dhe Komunitat, janë përgjegjëse të përgatisin dhe të aprovojnë me shkresë përmes ZKA dhe ZKF të OB-së listat e personelit të tyre dhe të njëjtat të përcillen në MASH, të cilat pasi konstatohet përputhshmëria me kriteret e këtij vendimi dhe udhëzimeve nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Arsimit dhe Shkencës me shkresë të veçantë dërgohen në Thesarin e Kosovës, për procesim përmes Sistemit të pagave.
2. Për sektorin e sigurisë, përkatësisht zyrtarët policorë, ndahen mjetet shtesë financiare në vlerë prej 700,000 € (shtatëqind mijë euro), në kategorinë e shpenzimeve "Paga dhe shtesa", për organizatën buxhetore Ministria e Punëve të Brendshme, nën-programi "Shërbimet administrative" me kod 30000, për pagesën e shtesës në pagë për zyrtarët aktiv policorë për angazhimin e shtuar në terren dhe të ekspozuar drejtpërdrejt në zbatimin e detyrave në menaxhimin e pandemisë COVID-19, të cilët nuk kanë përfituar nga Vendimi Nr. 06/59 i datës 21.01.2021. Shtesa në pagë sipas këtij paragrafi paguhet për dy muajt shkurt dhe mars 2021 për secilin muaj veç e veç në vlerë prej 100 € (njëqind euro) për muaj për person sipas listës së përfituesve të dorëzuar nga Policia e Kosovës (Ministria e Punëve të Brendshme) në Thesar, me të gjitha të dhënat tjera të nevojshme për zbatimin e vendimit. Lista e përfituesve sipas pikës 2. të këtij vendimi aprovet nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë dhe Ministri i Punëve të Brendshme, dhe dorëzohet me shkresë përcjellëse në Thesarin e Kosovës, për procesim përmes Sistemit të pagave.
3. Për sektorin e emergjencave, përkatësisht Zjarrfikësit, ndahen mjetet shtesë financiare në vlerë totale prej 180,000 € (njëqindtëtdhjetë mijë euro), për pagesën e shtesave për zjarrfikësit aktiv për angazhimin e shtuar në terren dhe të ekspozuar drejtpërdrejt ndaj pandemisë COVID-19. Shtesa në pagë sipas këtij paragrafi paguhet për dy muajt shkurt dhe

mars 2021 për secilin muaj veç e veç nga 100 € (njëqind euro) në muaj për person sipas listës së përfituesve të dorëzuar në Thesar nga Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave (AME) në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), me të gjitha të dhënat tjera të nevojshme për zbatimin e vendimit. Komunitat dhe AME (MPB) janë përgjegjëse të përgatisin dhe të aprovonjë me shkresë përmes ZKA dhe ZKF të OB-ve listat e përfituesve të shtesës në pagë dhe të njëjtat përcillen në AME (MPB), të cilat pasi konstatohet përputhshmëria me kriteret e këtij vendimi nga AME (MPB), me shkresë të veçantë dërgohen në Thesar, për procesim përmes Sistemit të pagave.


4. Për sektorin social, ndahen mjetet shtesë financiare në vlerë 78,000 € (shtatëdhjetetë mijë euro), për pagesën e shtesave në pagë për punëtorët aktiv social në Qendrat për Punë Sociale, për angazhimin e shtuar në terren dhe të ekspozuar drejtpërdrejt ndaj pandemisë COVID-19. Shtesa në pagë sipas këtij paragrafi paguhet për dy muajt shkurt dhe mars 2021 për secilin muaj veç e veç nga 100 € (njëqind euro) në muaj për person sipas listës së përfituesve të dorëzuar në Thesar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), me të gjitha të dhënat tjera të nevojshme për zbatimin e vendimit. Komunitat janë përgjegjëse të përgatisin dhe të aprovonjë me shkresë përmes ZKA dhe ZKF të OB-së listat e personelit të tyre me kategorizimin e përcaktuar më lartë dhe të njëjtat përcillen në MPMS, të cilat pasi konstatohet përputhshmëria me kriteret e këtij vendimi dhe udhëzimeve nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Ministrit të MPMS-së me shkresë të veçantë dërgohen në Thesar, për procesim përmes Sistemit të pagave.
5. Për sektorin shëndetësor (në të gjitha nivelet) ndahen mjetet financiare si në vijim:
  - 5.1. Shuma prej 100,000 € (njëqind mijë euro) për pagesën e shtesave në pagë për profesionistët shëndetësorë që kryejnë shërbime shëndetësore në sektorin publik bazuar në marrëveshjet kontraktuale që kanë me organizatat buxhetore në nivel lokal. Shtesat paguhet për dy muaj shkurt dhe mars 2021 për secilin muaj veç e veç nga 100 € (njëqind euro) në muaj për person sipas listës së dorëzuar në Ministrinë e Shëndetësisë nga secili institucion publik shëndetësor që ka shërbime të tilla të kontraktuara. Ministria e Shëndetësisë pas pranimit të listave të nënshkruara nga ZKA dhe ZKF i organizatës përkatëse, me shkresë përmes ZKA dhe Ministrit të Shëndetësisë, pasi konstatohet përputhshmëria me kriteret e këtij vendimi, me shkresë të veçantë i dërgon në Thesar për procesim më tutje përmes SIMFK, në kategorinë subvencione dhe transfere.
  - 5.2. Shuma prej 160,000 € (njëqind e gjashtëdhjetë mijë euro) për pagesën e shtesave në pagë për punëtorët teknik të sektorit privat (pastrimi dhe sigurimi fizik) që kryejnë shërbime të kontraktuara për institucionet publike shëndetësore, për dy muaj shkurt dhe mars 2021 për secilin muaj veç e veç nga 100 € (njëqind euro) për muaj për person sipas listës së dorëzuar nga Sindikata e Pavarur e Sektorit Privat të Kosovës në Ministrinë e Shëndetësisë, me të gjitha të dhënat e nevojshme për zbatim të këtij vendimi. Ministria e Shëndetësisë pasi konstaton përputhshmërinë e saj me kriteret e këtij vendimi, me shkresë të veçantë i dërgon në Thesar për procesim më tutje përmes SIMFK, në kategorinë subvencione dhe transfere.
6. Kategoritë tjera të sektorit publik që janë të angazhuar në menaxhim të pandemisë dhe janë të ekspozuar ndaj rrezikut të infektimit nga COVID-19, që nuk janë pjesë e këtij vendimi apo vendimeve paraprake për shtesa të tilla, do të mund të trajtohen me vendime të veçanta të bazuar në vlerësimet profesionale të nivelit të ekspozimit ndaj rrezikut dhe mundësitë buxhetore, duke filluar nga muaji mars 2021 e tutje.
7. Mjetet për zbatimin e këtij Vendimi ndahen nga nën programi "Programi për Rimëkëmbje Ekonomike (MF)" me kod 29300, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere" dhe ndahen tek organizatat buxhetore përgjegjëse për zbatim të masave sipas pikës 1-5 të këtij vendimi.

8. Autorizohet Ministria e Financave që pas pranimit të listave përfundimtare sipas këtij vendimi, të bëjë ndarjen buxhetore nga pika 7 e këtij vendimi, për dy muaj te secila OB, në nën programet buxhetore përkatëse në kategorinë e shpenzimeve "Paga dhe shtesa" (për pikat 1-4 të këtij vendimi) dhe në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe transfere" (për pikën 5), bazuar në shumën e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi, ndërsa alokimi i mjeteve bëhet çdo muaj, bazuar në çekun e përlllogaritur të pagave së bashku me shtesat përkatëse, përkatësisht planit të rrjedhës së parasë për subvencionet nga pika 5 e vendimit.
9. Pagesa e shtesës mbi pagë realizohet përmes Sistemit të Pagave, në baza mujore, me pagën e muajit përkatës. Në rast se listat përfundimtare sipas këtij vendimi procedohen në Thesar me vonesë, jashtë afatit për procedimin e ndryshimeve në Sistemin e Pagave, të njëjtat shtesa procedohen me pagën vijuese, si pagesë retroaktive e shtesës.
10. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Komunitat, Policia e Kosovës, Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave, Ministria e Financave dhe Thesari për zbatimin e këtij vendimi.
11. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

## ARSYETIM

Institucionet e lartpërmendura kanë bërë kërkesë në Qeveri për kompensimin financiar lidhur me angazhimin e shtuar në punë dhe ekspozimit ndaj pandemisë COVID-19. Ky vendim adreson kërkesat minimale të tyre në përputhje me mundësitë buxhetore.

Avdullah HOTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

### Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë